

RELACION TEKNIK

OBJEKTI:

SISTEMIM ASFALTIM I RRUGES NE FSHATIN LEKAJ

RELACION TEKNIK
MBI PROJEKTIMIN E OBJEKTIT : SISTEMIM ASFALTIM I RRUGES NE FSHATIN LEKAJ

Organizimi i projektit do te kaloje ne disa etapa te vecanta te cilat do te pasqyrohen si me poshte ne kete pershkrim teknik.

I- Pershkrimi i punimeve pergatitore

1 Menytrat e projektimit.

Per kryerjen e projektimit jane bere matje ne terren topografike dhe ato gjeologjike, mbas marrjeve e te dhenave topografike dhe gjeologjike fillojme llogaritjet per profilin gjatesore dhe planimetrine e rruges. Mbasi kemi projektuar profilin gjatesore dhe planimetrine e rruges bejme te gjitha profilet terthore mbi te cilet ne mund te percaktojme volumet qe dalin nga kjo vije projekti qe ne kemi hartuar.

2 Menytrat e zbatimit.

Per kryerjen e zbatimit te projektit duhet te merret parasysh dhe nje pasaktesi e vegjel ne kuotat e projektit ose kuotat e tokes te cilat nuk mund te jene obsulutisht te sakta per shkak se jane punuar ne fotogometri. Ne punimet pergatitore futen ngritja e kantierit dhe magazinave per mbajtjen e matrialeve dhe ngritjen e zyrave per grupin e inxhinierëve te cilet do te punojne ne kete objekt. Perpara se te fillojne punimet ne terren duhet te behet nje kontroll te plote te projektit ne lidhje me terrenin dhe te shikohen te dhenat e projektuesit te cilat jepen ne fletet e projektit, si dhe shenimet perkatese.

II- Pershkrimi i kryerjeve te punimeve

Sipas rradhes se punes fillohet nga gerrmimet e dherave, nivelimet dhe mbushjet me makineri (me krahe per nivelimin ose aty ku eshte e nevojshme). Nivelimi dhe mbushja do te kete gjeresine sa gjeresia e kalimit te rruges 4ml asfaltobeton, 0.5ml bankina anesore ne te dyja anet e rruges .

Eshte parashikuar sistemimi i ujrave siperfaqesore te kodres, duke i mbledhur ne nje kanal te hapur i veshur me beton , nga ana e kodres sipas projektit.

Gjithashtu eshte parashikuar edhe riparimi i tombinove ekzistuese me ato te reja me diameter Ø600 sipas projektit.

Hyrjet ne ndertesa do te realizohen me nje gjeresi 3ml me tombino Ø500.

III- Pershkrimi i materialeve

Materialet qe do te perdoren per shtesat e rruges duhet te jene:

- 1- Çakell 8cm ne gjithë gjetesine e rruges.
- 2- Stabilizant 5cm ne gjithë gjetesine e rruges.
- 3- Binder 5cm per ne gjithë gjetesine e rruges.
- 4- Asfaltobeton per shtresen e fundit prej 3cm ne gjithë gjetesine e rruges.

IV- Pershkrimi i makinerive

Makinerite qe do perdoren per zhvillimin e punimeve duhet te jene: eskavator per germimin e dherave, grejder per nivelim, kamione te tonazheve te rende per largimin e inerteve dhe furnizimin me materiale per shtesat e rruges, rrule per ngjeshjen e shtresave, betonire per kryerjen e betonit ne vepren e artit, vegla per puntorine te cilet do ndihmojne ne nivelim ose per kryerjen e betonit etj.

V- Organizimi i punimeve

Punimet ne objekt do te perfundojne sipas grafikut te percaktuar qe paraqitet vecanti. Per realizimin me cilesi te punimeve dhe brenda afatit te percaktuar, firma ndertuese do te mobilizojë numerin e nevojshem te makinerive, specialisteve dhe stafin drejtues dhe do te zbatoje te gjitha standartet kushtet teknike dhe teknologjine e zbatimit per kryerjen e punimeve ne objekt.

Pershkrimi teknik dhe grafiku i punimeve eshte nje program i plote qe percakton rendin proceduren dhe metodën sipas te cilave firma kontrktuese propozon te punohet ne ndertimin e ketij objekti deri ne mbarimin e plote te punes dhe perfundimin e tije.

Per organizimin e punes ne objekt do te behet ndarja e punimeve ne procese te te vecanta ku do te punohet ne menyre te pavarur ne secilin proces. Kryerja e punimeve do te behet e ndare ne disa pjese qe do pefshije; Germimin dhe hapjen e kanaleve anesore ne rastet kur kemi germim (dhe pastrim kanali ose hapjen e tije). Ne rastin kur kemi mbushje do behet hedhja e shtresave.

Duhet detyrimisht te merren masa per kufizimin e levizjes se njerezve dhe automjeteve ne zonen ku do te kryhen punimet ne menyre qe gjate kryerjes se punimeve te mos kete levizje te pakontrolluara te njerezve dhe automjeteve te cilat do te pengojne punimet dhe do te demtojne punimet si prishjen e trasese se rruges dhe demtimin e saj.

Punoi: Ing.Ariola Dylia

Zyra e projekteve
Ark.Maksim Cuko

Drejtoria e Planifikimit
Ing.Mimoza Haxhiu